



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E SPITALIT PSIKIATRIK

Vlorë, më ____ . ____ .2024

Lënda: PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - MALL

**ARGUMENTIM DHE MIRATIM I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot më datë 10.05.2024, në Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”, nga Njësia e Prokurimit, ngritur nga Autoriteti Kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme :

Objekti Prokurimit: “Blerje Medikamente” për Spitalin Psikiatrik “Ali Mihali”

Referenca: REF- 05764-05-20-2024

Vlera e fondit limit: 1399,731 (treqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e shtatëqind e tridhjetë e një) lekë pa TVSH.

Vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor (AK) për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë. Nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të Ligjit Nr.162 dt.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” në nenin 77 pika 1 dhe pika 4, i cili parashikon se: “[...] Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas njëstandardi të përshtatshëm cilësie”.

Në bazë të kriterëve të veçanta të kualifikimit hedhur në sistemin e APP^{së} sipas Dokumentave Standarte të Tenderit (DST) AK hartoi DST^{ën}, mbështetur në ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe në VKM Nr.285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke përcaktuar kërkesat e veçanta për kualifikim.

Adresa: Lgji.“10 Korriku” Rr.“Ibrahim Avdullahu” Vlorë Tel/Fax: +355 (0) 33 205-105 E-mail: s_psikiatrik_vl@yahoo.it

(përveç kriterëve të përgjithshme që janë të pa ndryshueshme në DST)

Për sa më sipër AK argumenton këto kritere, referuar VKM Nr.285/ 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V "Dokumentet e Tenderit":

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Argumentimi: Mbështetur në Ligjin nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 41/5 pika a: 5. Për të provuar se, operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që: a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Licencë e lëshuar nga QKL ose QKB për tregtim me shumicë të barnave

Argumentimi: Ky kriter mbështetet ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" neni 77 pika 1 ku për të vërtetuar se Operatori Ekonomik pjesëmarrës kryen veprimtari sipas objektit të procedurës së prokurimit, AK kërkon nga OE paraqitjen e një dokumenti ligjor i cili shërben për të vërtetuar veprimtarin që OE kryen si dhe është ose jo në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit.

2.2 Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1 Vertetim nga dega e tatim taksave ku te vertetohet realizimi i xhiros mesatare vjetore, ne nje vlere deri ne 40% te fondit limit te lotit/ loteve për të cilat OE merr pjese per 3 (tre) vitet e fundit financiar (2021, 2022, 2023).

Argumentimi: Operatori ekonomik nëpërmjet deklaratimit të xhiros vjetore, duhet të tregojë nëse ka kryer xhiro për vitet e kërkuara, ne nje vlere deri ne 40% te fondit limit te lotit/ loteve që do prokurohet. Kjo kërkesë mbështetet në ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" neni 77 si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43 pika 1: kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2.3 Për kapacitetin teknik:

Referuar Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 77 pika 4 parshikon: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

2.3.1 Furnizime të mëparshme, të ngjashme, në një vlerë deri në 20% të fondit limit të lotit/ loteve për të cilat OE merr pjese. Furnizime këto të realizuara gjatë tre viteve të fundit (2021, 2022, 2023) nga data e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi: Vendosija e këtij kriteri tregon faktin që operatorët ekonomike kanë realizuar gjatë tre viteve të kërkuara kontrata të ngjashme të përmasave të tilla me objektin që prokurohet. Ky kriter mbështetet ligjin Nr.162, datë 23.12.2021 "Për Prokurimin Publik", neni 77 pika 4 si dhe VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 55 pika 4/b.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2024.

Argumentimi: AK ka vendosur këtë kërkesë për të vërtetuar se operatorët ekonomik të cilët ushtrojnë aktivitetin e kërkuar për realizimin e kontratës janë të rregullt në pagesat e taksave vendore të vendit ku ata do të ushtrojnë aktivitetin e tyre, taksa të cilat çdo subjekt që kryen një aktivitet ekonomik duhen të paguhet, si dhe për të mos patur detyrime ekonomike ndaj Institucioneve Shtetërore. Referuar ligjit Nr.162, date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik", neni 76 pika 2.

2.3.2 Vetedeklarim për origjinën e mallit ku të percaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese.

2.3.3 Për barna të autorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, duhet të paraqitet dokument lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore që bari i ofruar është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë ose certifikatë regjistrimi e barit për tregtim në RSH, brenda afatit të vlefshmërisë.

2.3.4 Për barnat të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofrohet duhet:

- të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi; ose

- *të jetë i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm kur ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tyre, ose*
- *te jetë i pajisur me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.*

Për këtë kërkohet që ofertuesi të paraqesë:

- Deklaratë me anën e të cilës të konfirmohet se bari që ofron është i pajisur me autorizim tregtimi dhe qarkullon në një nga vendet e mësipërme ose që disponon autorizim tregtimi nga FDA ose EMA.
Në deklaratën e nëshkruar dhe të vulosur nga ofertuesi duhet të deklarohen: Emri dhe adresa e plotë e Institucionit/eve të autorizuar që kanë leshuar autorizimin e tregtimit; Të dhëna kontakti për këto institucione (Tel, fax, e-mail, ëeb-site); Data e lëshimit të autorizimit të tregtimit të barit që ofron, (pranë këtij institucioni) dhe periudhën e vlefshmërisë të këtij autorizimi.

Argumentimi: Për të pasur një cilësi sa më të lartë dhe produkte origjinale të ardhur nga firma prodhuese dhe jo nga firma fantazëm, kërkojmë nga operatori pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të disponojnë deklaratë mbi origjinën, autorizimin nga firma prodhuese për operatorin shitës si dhe katalogët me specifikimet teknike përkatëse si dhe të vulosur nga operatori pjesëmarrës për efekt sigurie dhe autentikitet. Për këto kritere jemi bazuar ne Ligjin Nr.162/ 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 77 si dhe në nenin 79.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
PERSONI I AUTORIZUAR
Loreta BALAJ